



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 13
Prishtinë, më 12. 11. 2008, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Enis Kervan, Ramadan Avdiu, Eqrem Kryeziu, Lutfi Haziri, Ibrahim Gashi dhe Ardian Gjini.

Munguan: Ramë Buja, Nexhat Daci dhe Dragisa Miric.

Në mbledhje sipas ftesës ishte i pranishëm Khaldoun Sinno - shef i Sektorit për Integritet Evropian i Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit, me këtë

R E N D I T E

- 1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 2. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën: Renzo Daviddi,**
- 3. Ftesa e Komisionit për Politikë të Jashtme të Kuvendit të Shqipërisë,**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

U miratua procesverbali i mbledhjes së kaluar.

2. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën: Renzo Daviddi

Sabri Hamiti i njoftoi anëtarët e Komisionit se për këtë mbledhje ka qenë i ftuar z. Renzo Daviddi, shef i Zyrës Ndërlidhëse të KE-së, mirëpo në mungesë të tij tha se është i pranishëm z. Klaudon Sinno që do t'i prezantojë pikat themelore të këtij raporti.

Klaudon Sinno lidhur me raportin e progresit për Kosovën tha se është një vlerësim i përgjithshëm i zhvillimit të situatës politike, ekonomike dhe i mënyrës së zbatimit të politikave të BE-së tetor 2007-tetor 2008. Po ashtu shtoi se është propozuar të bëhet një studim i fizibilitetit për Kosovën dhe të prezantohet në fund të vitit të ardhshëm.

Për hartimin e raportit tha se informacionet janë marrë nga Zyra Ndërlidhëse e KE-së, nga projektet nëpër institucione të ndryshme të Kosovës, nga raportet e shoqërive civile dhe nga organizatat ndërkombëtare, në bazë të të cilave është konkluduar se në Kosovë janë arritur disa progrese pozitive, si mirëmbajtja e stabilitetit, bashkëpunimi i mirë me bashkësinë ndërkombëtare, nxjerrja e Kushtetutës në

harmoni me standardet evropiane, harmonizimi me Kushtetutë i legjislacionit të nxjerrë pas miratimit të Kushtetutës, bashkëpunimi rajonal dhe zhvillimi i ekonomisë.

Sa u përket sfidave, është konstatuar se ka nevojë për avancim të bashkëpunimit ndërministror, sepse sistemi juridik është i dobët, ka korrupsion dhe krim të organizuar - kryesisht në pjesët e pakontrolluara të territorit edhe moszbatim të dispozitave të Kushtetutës për komunitetet.

Lidhur me Kuvendin tha se duhet të përmirësohet bashkëpunimi me Qeverinë, të zgjidhet avokati i popullit, sepse mungesa është shënuar një rritje, por fort e brishtë, për shkak të mungesës së infrastrukturës. Në vazhdim tha se do të bashkëpunojmë me Qeverinë për një angazhim të Kosovës drejt BE-së. Lidhur me këtë do ta mbajmë mekanizmin e gjurmimit dy herë në vit, kurse takimi i MPSA-së do të mbahet më 2 dhjetor. Do të ketë mundësi modifikimi të PVPE-së, në mënyrë që të aplikohen konstatimet e KE-së, si dhe do të organizohet një dialog sektorial i nivelit teknik ndërmjet administratës së Kosovës dhe të Brukselit për çështje teknike, për infrastrukturën, për bujqësinë etj.

Sabri Hamiti mendon se raporti e paraqet një pasqyrë të saktë të zhvillimeve politike dhe ekonomike në këtë periudhë një vjeçare, duke i pasur parasysh edhe elementet që i pengojnë zhvillimet në Kosovë. Çështje që e pengojnë zhvillimin demokratik të Kosovës mendon se janë zbatimi i tri llojeve të ligjeve në Kosovë, si dhe funksionalizimi i strukturave paralele në komunat me shumicë serbe. Sa u përket konstatimit të mosveprimit të duhur ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë dhe kërcënimit e ndikimit politik ndaj mediave, është çështje që duhet të na preokupojë, ndërsa çështja e korrupsionit dhe e krimit të organizuar janë sfera të kushtëzuara nga faktori ndërkombëtar.

Ibrahim Gashi ndër të tjera kërkoi të informohet a ka pasur paralajmërime për Qeverinë për pikat që më vonë dalin në raport se ka munguar progresi. Lidhur me vërejtjet e evidencuara në raportin e KE-së tha se edhe ne si opozitë kohë pas kohe i kemi shtruar në Qeveri. Për vërejtjet e argumentuara në raport, mendon se është koha e fundit të korrigjohen nga institucionet përkatëse.

Lutfi Haziri lidhur me raportin tha se e pasqyron realitetin në Kosovë dhe është i pranueshëm, sepse është negociuar me Qeverinë. Ai duhet të pranohet nga aspekti i zbatimit, nëse dëshirojmë ta shtyjmë agjendën përpara. Meqë Kosova nuk ka agjendë të qartë të perspektivës evropiane, kërkoi të informohet se cilat janë rekomandimet e sakta për studimin e fizibilitetit, meqë mendon se deri në vitin e ardhshëm raporti do të paraqitet me probleme pak a shumë të njëjta, nëse nuk i shtohet tani edhe problemi i 6-pikëshit.

Xhavit Haliti deklaroi se pajtohet për shumicën e çështjeve të evidencuara në raport dhe shpreson se mangësitë e evidencuara, do të merren parasysh me qëllim që të arrihet progres dhe të shtyhet përpara agjenda e Kosovës drejt integritit në BE.

Ardian Gjini theksoi se evidencimet në raport janë befasuese kur flitet për rindërtimin e objekteve të trashëgimisë fetare e kulturore, si p.sh.: ku thuhet se në rrënojat e një kisha të Gjakovës, të shkatërruar në vitin 2004, është ndërtuar një park. Kjo nuk është e saktë. Po ashtu shtoi se KE-ja duhet të ndihmojë për interpretimin e të dhënave, siç është rasti me gjyqësorin.

Ramadan Avdiu mendon se të gjitha të dhënat në raport duhet të merren parasysh, në mënyrë që raporti i vitit të ardhshëm të jetë më përsosur. Në vazhdim tha se nuk pajtohet me deklaratimet e disa kolegëve se raporti ka saktësi të plotë. Të dhënat se jashtë Kosovës jetojnë 206 mijë të zhvendosur, nuk janë të sakta, nga se ata nuk janë më tepër se 120 mijë.

Eqrem Kryeziu lidhur me raportin tha se kritikën e evidencuara për krimin e organizuar dhe sundimin e ligjit i konsideron si komplimente, pasi institucionet e Kosovës nuk kanë pasur përgjegjësi të plotë në këta sektorë. Po ashtu raporti do të duhej të ishte më objektiv, të paktën me rastin e shfaqjes së përshtypjeve lidhur me pakënaqësitë e komuniteteve. Shtoi se është normale që në një shoqëri që del nga

konflikti të ketë pakënaqësi nga të gjitha komunitetet, mirëpo Kosova edhe në organin më të lartë i ka të garantuara vendet e përfaqësuesve të komuniteteve të tjera.

Enis Kervan duke e pasur parasysh se në raport është përmendur se gjuha serbe nuk përdoret sa duhet, shtoi se edhe në komunat ku komuniteti serb është shumicë, gjuha shqipe nuk përdoret. Evidencimi se turqit dhe boshnjakët nuk kanë tekstet shkollore, nuk qëndron, ngase ne i kemi mbi 70% të teksteve. Në raport nuk përmenden fare hapat pozitivë që janë bërë në Mamushë, që është e banuar nga komuniteti turk. Po ashtu shtoi se sipas Kushtetutës, Kosova komunitetet jo shumicë i quan komunitet, ndërsa në raport quhen minoritete dhe kërkoi që kjo të përmirësohet nga hartuesit e raportit.

Klaudon Sinno pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, tha se raporti mund ta ketë ndonjë mangësi në shifrat për komunitetet jo shumicë, që janë marrë nga UNHCR-ja, që është një organizatë neutrale, ndërsa disa nga faktet mund t'i adresoni vetëm në rajon, si për shembull krimin e organizuar.

Kuvendi ka qenë i zënë me legjislacionin e Pakos së Ahtisarit dhe e ka pasur një periudhë me shumë angazhime. Në vitin e ardhshëm do ta kemi një zhvillim më të madh, meqë nuk do të jenë këto mbingarkime. Lidhur me tekstet shkollore të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe me rrënojat e kishës së Gjakovës, do të bisedojmë në ndonjë takim të nivelit bilateral. Komisioni Evropian ka agjendë dhe orar të saktë për ta angazhuar dhe për ta shtyrë Kosovën përpara.

3. Ftesa e Komisionit për Politikë të Jashtme të Kuvendit të Shqipërisë

Xhavit Haliti i njoftoi anëtarët e Komisionit se nga komisioni homolog i Shqipërisë është ftuar një delegacion 6-anëtarësh dhe një përfaqësues nga stafi për vizitë pune dyditore në Shqipëri brenda periudhës 23 - 30 nëntor.

Komisioni e shqyrtoi ftesën për vizitë dhe lidhur me të e nxori këtë

P ë r f u n d i m

Delegacioni i Komisionit për Punë të Jashtme në përbërje: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Enis Kervan, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Ardian Gjini dhe një përfaqësues i stafit do të udhëtojnë për vizitë pune më 26 dhe 27 nëntor në Shqipëri, sipas ftesës së komisionit homolog.

4. Të ndryshme

Xhavit Haliti tha se është parashtruar një kërkesë nga deputeti Sadik Idriz nr. 1238, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit me rastin e pjesëmarrjes së tij me delegacion shtetëror në Shqipëri nga 3 – 5. 10. 2008, sipas ftesës së Presidentit. Në vazhdim tha se institucionet që i ftojnë për vizitë deputetët, duhet t'i përballojnë edhe shpenzimet e udhëtimit të tyre.

Komisioni pas diskutimit lidhur me kërkesën e deputetit Sadik Idriz e nxori këtë

P ë r f u n d i m

Kërkesa e deputetit Sadik Idriz për kompensimin e të gjitha shpenzimeve me rastin e vizitës në Shqipëri nga 3 - 5 nëntor 2008, të zgjidhet në mënyrë analoge, siç është vepruar për deputetët e tjerë, pjesëmarrës të delegacionit shtetëror në këtë vizitë.

Mbledhja përfundoi në orën 15:15.

Përgatiti:

Njësia për mbështetje të Komisionit

Kryetari i Komisionit
Sabri Hamiti